

Kantoni Zug

Mirë se erdhët!

Botimi:

© *Fachstelle Migration*

Botimi I 2004: 1500 kopje

Redaktoi: Yüksel Tellici

Fotografitë: Zug Tourismus, Yüksel Tellici, Daniel Christen

Dizajnimi:

Shtypi:

Përktheu: Skënder Reçi

Mirë se erdhët në Zug botohet në këto gjuhë:

Shqip, gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht, portugalisht, serbisht/ kroatisht/ boshnjakisht, spanjisht, tamilisht dhe turqisht.

Parathënie

Të dashur banorë të rinj të Zug-ut

Bashkëjetesa e njerëzve nga regjione dhe kultura të ndryshme është një sfidë. Nëse e tejkaloni me sukses, pasurohet e tërë shoqëria.

Nuk ka kaluar shumë kohë që jeni vendosur në kantonin e Zug-ut. Në ditët e para për ju shumëçka është e panjohur: Si t'i gjeni të gjitha ato që ju duhen në jetën e përditshme; ku ndodhen entet, mjeku, shkollat për fëmijet tuaj dhe shumëçka tjetër. Përveç kësaj, për ju edhe gjuha - gjermanishtja e Zvicrës, të cilën ju ndoshta ende nuk e kuptoni, e vështirëson kontaktin me njerëzit. Zakonet dhe rregullat janë për ju të panjohura. Të gjitha këto mund t'ju mendojnë, edhe pse ndoshta mund të jenë frymëzuese dhe interesante për ju.

Nga zemra ju dëshiroj mirëseardhje në kantonin tonë dhe uroj që të ambientoheni shpejt në mjedisin e ri, të ndiheni mirë dhe të miqësoheni me njerëzit e këtushëm.

Kjo broshurë mirëseardhjeje do t'ju ndihmojë që ju të gjendeni dhe të mësoni ku mund të gjeni informata të nevojshme. Broshurën mund ta gjeni në dhjetë gjuhë. Shpresoj se do t'ju shërbejë mirë.

Historia na mëson: Ekonomia, kultura dhe shkencat jetojnë dhe zhvillohen që kur ekziston njeriu, duke iu falenderuar bashkëpunimit mes kulturave dhe vendeve në të gjithë rruzullin tokësor. Edhe ju e jepni kontributin tuaj në këtë aspekt. Për këtë ju falenderoj dhe më vjen mirë që jeni këtu dhe që fuqinë tuaj punëtore, njohuritë, idetë dhe përvojën tuaj e shkrini këtu.

Brigitte Profos, anëtare e qeverisë
Drejtoreshë e Punëve të Brendshme

Kantoni i Zug- ut shkurtimisht

Pozita gjeografike

Kantoni i Zug- ut ka një sipërfaqe prej 240 km² dhe është kantoni më i vogël prej kantoneve të plota në Zvicër. Ai ndodhet në qendër të Evropës, në zemër të Zvicrës, pranë Alpeve dhe ka një relief kodrinor interesant me pejzazhe joshëse. Me mjetet e transportit publik dhe atij privat, si prej Zürich- ut, ashtu edhe prej Luzern- i, arrihet për më pak se 30 minuta. Kryeqendra e kantonit është Zug- u. Liqenet pitoreskë, *Zugersee* dhe *Ägerisee*, e bëjnë *Zugerland-in* të paharrueshëm.

Mentaliteti i popullatës së Zug- ut karakterizohet me lidhjet shpirtërore ndaj Luzern- it dhe ndaj kantoneve tjera të Zvicrës qendrore dhe me marrëdhëniet ekonomike me metropolin e Zürich-ut.

Popullsia:

Popullsia është relativisht e re dhe në 40 vitet e fundit është dyfishuar. Në kantonin e Zug- ut sot jetojnë pjesëtarë të mbi 90 kombeve, të cilët i kontribuojnë një internacionaliteti të dukshëm në këtë regjion. Të ardhurit - migrantët përbëjnë plot 20% të popullsisë së përgjithshme. Shumë prej tyre marrin pjesë në një nga 50 organizatat apo shoqatat e të ardhurve. Një numër i madh i popullsisë flet më shumë se një gjuhë. Gjuha zyrtare është gjermanishtja, mirëpo në biznes përdoret gjithnjë e më shumë gjuha angleze.

11 komunat e Zug- ut

Kantoni i Zug-ut ndahet në 11 komuna politike, të cilat kanë një pavarësi të lartë. Katër komunat: Oberägeri, Unterägeri, Menzingen dhe Neuheim i takojnë zonës malore, ndërsa komunat Zug, Baar, Steinhausen, Risch, Cham, Hünenberg dhe Walchwil shtrihen në zonën fushore. Një pjesë e madhe e tyre shtrihet rreth e përqark Liqenit të Zug- ut.

Komuna	Numri i banorëve	Sipërfaqja	Lartësia mbidetare
Zug	23.325	33.8 km ²	425 m
Oberägeri	4.910	36.2 km ²	737 m
Unterägeri	7.396	26.7 km ²	729 m
Menzingen	4.306	27.5 km ²	807 m
Baar	20.024	24.8 km ²	444 m
Cham	13.320	19.1 km ²	418 m
Hünenberg	7.792	18.7 km ²	451 m
Steinhausen	8.701	5.1 km ²	424 m
Risch	8.002	22.9 km ²	417 m
Walchwil	3249	15.9 km ²	449 m
Neuheim	1992	7.9 km ²	666 m

Gjithsej	103.017	238.6 km ²	
----------	---------	-----------------------	--

Gjendja më 31. 12. 2003

Organet qeverisëse

Qeveria

Qeveria është organ administrativ dhe ekzekutiv. Në çdo katër vjet, bashkë me anëtarët e parlamentit, populli i zgjedh edhe 7 anëtarët e qeverisë. Qeverinë e Kantonit të Zug-ut, në periudhën legjislative 2003 – 2006 e përbëjnë: dy përfaqësues të CVP (Partia popullore demokristiane), dy të FDP (Partia demokrate liberale) një i SP (Partia socialdemokrate), një anëtar i SGA (Fraksioni alternativ) dhe një anëtar i SVP (Partia popullore zvicerane).

Parlamenti Kantonal

Populli i Zug-ut zgjedh në çdo katër vjet 80 anëtarë të Parlamentit. Këta angazhohen për interesat e popullit, diskutojnë dhe vendosin në emër të tij mbi detyrat e përbashkëta. Parlamenti takohet zakonisht një herë në muaj. Punimet e tij janë të hapura për çdo qytetar dhe mund të ndiqen në sallën e parlamentit.

Fraksionet e Parlamentit Kantonal dhe vendet e tyre në periudhën legjislative 2003-2006

- Partia Demokristiane Popullore (CVP)- 25 vende
- Partia Demokrate Liberale (FDP) - 20 vende
- Partia Socialdemokrate (SP) - 9 vende
- Fraksioni Alternativ (AF) - 8 vende
- Partia Popullore Zvicerane (SVP) - 18 vende

Politika dhe partitë: panorama jonë politike

A dëshironi të angazhoheni në politikë? Nëse po, atëherë ekziston mundësia të anëtarësoheni në ndonjë parti. Informata mund të merrni në sekretariatet e partive (shikoni adresat në faqen e internetit të kantonit të www.zug.ch/ → Zuger links → Parteien → Politik)

Çfarë është më e rëndësishme në jetën e përditshme

Komunikacioni në Zug

Kantoni i Zug-ut ka një rrjet të ndërtuar mirë të mjeteve publike të komunikacionit. Këto mjete publike të komunikacionit në Zug janë bashkuar në Unionin tarifor duke arritur një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim që në kantonin e Zug-ut dhe në komunat e kanto-veve fqinje, që shtrihen rreth kufirit, të ofrojnë shërbime të volitshme për klientët e tyre. Unioni tarifor ofron bileta të shumëllojshme të udhëtimit, që janë të vlefshme në të gjitha mjetet transportuese, ndërsa oraret e udhëtimit të tyre i janë përshtatur njëri tjetrit. Me biletën e Unionit tarifor të Zug-ut mund të udhëtoni me autobus, me tren, me trenin e Zugerberg-ut, me autobusin e postës, me ekspresin e natës dhe me anije. Të dhëna të sakta mbi orarin e udhëtimit, llojin e biletave, vlefshmërinë e tyre, vendin ku blihen ato, etj. janë dhënë në libërthin e orarit të udhëtimeve, të cilin mund ta gjeni në :

Zug Tourismus, Reisezentrum Zug, Bahnhofplatz, 6304 Zug, Tel. 041 723 68 00, në internet: www.zug-tourismus.ch

Informata mund të merrni edhe përmes internetit në këtë adresë: www.zvb.ch.

Me automjet

Informata të përgjithshme mbi udhëtimin me automjet në Zvicër.

- Shpejtësia maksimale e lejuar: në vendbanime 30/50 km/h, jashtë vendbanimeve 80 km/h, në autostradë 120 km/h
- Vinjeta për autostradë (Fr. 40.- për vit kalendarik) është e obligueshme. Mund ta bleni në: doganë, në Entet e Komunik. Rrugor, në postë dhe në pompat e benzinës.
- Rripi siguruës është i obligueshëm në ulëset e përparme dhe në ato të prapmet.
- Sasia maksimale e lejuar e alkoolit të konsumuar kur jeni duke drejtuar automjetin është 0.8 promilë (prej 01.01. 2005 do të jetë 0.5 promilë).
- Në rast aksidenti: ju këshillojmë që ta thirrni policinë. Nëse ka të lënduar thirrja e policisë është e detyrueshme sipas ligjit.
- Ndërrimi i adresës: Lajmëroni Entin e Komunik. Rrugor Kantonal mbrenda 14 ditëve
- Në Zvicër, gjatë 12 muajve të parë guxoni të drejtoni automjetin nëse keni patentë shoferi të vlefshme, të lëshuar në vendin tuaj. Pas kalimit të këtij afati duhet që atë ta zëvendësoni me patentë zvicerane. Ata të cilët kanë për qëllim profesionalisht të merren me drejtimin e automjeteve të kategorisë C (kamionë), D (autobusë) ose D1 (Taxi) është e domosdoshme që të pajisen me patentë zvicerane, qysh para se ta fillojnë punën e tyre. Për informata:

Strassenverkehrsamt (Enti i komunikacionit Rrugor i Kantonit të Zug- ut)

Hinterbergstr. 41

6312 Steinhausen

Tel. 041 728 47 11

Sportelet janë të hapur: E hënë – e premte - 07.30 - 11.45 dhe 13.00 - 17.00

Me telefon: prej orës 7.30 – 11.45 dhe 13.00 - 17.00

Në internet: www.zug.ch/strassenverkehrsamt

Adresa elektronike: info.stva@sd.zg.ch

Tregu

Në shumë komuna, të shtunave bëhet pazari javor: Në Baar pranë Bashkisë (Rathaus), në Cham dhe Hünenberg në sheshin e fshatit (Dorfplatz), në Rotkreuz në Dorfmatplatz, në Oberägeri në oborrin e Ndërrmarrjes së Komunikacionit (ZVB).

linformata më të reja do të gjeni pranë komunës suaj, shtypin ditor, Fletën zyrtare (Amtsblatt) ose Kalendarin kulturor të kantonit të Zug- ut.

Panaiet (Chilbi)

Në komuna të ndryshme, brenda vitit mbahen panaiet. Këto ngjarje gjithmonë tërheqin shumë njerëz që kanë dëshirë të blejnë dhe të argëtohen. Gjatë Pashkëve dhe Rrëshajës pranë liqenit mbretëron gjallëri e madhe panairi.

linformata më të reja do të gjeni pranë komunës suaj, shtypin ditor, Fletën zyrtare (Amtsblatt) ose Kalendarin kulturor të kantonit të Zug- ut.

Mbeturinat: Ju lutemi t'i përdorni vetëm thasët “Zuger Gemeinden”

Për heqjen e mbeturinave duhet ta përdorni thesin e veçantë, “Zuger Gemeinden”. Në çmimin e blerjes së këtij thesi është përfshirë edhe taksa, e cila i mbulon shpenzimet e heqjes së mbeturinave. Përdorimi i thasëve, në çmimin e të cilëve nuk është përfshirë një taksë e tillë e detyrueshme, dënohet. Qelqi, konzervat, kanaçet si dhe pjesërisht rrobat dhe këpucët e vjetra, mund t'i hidhni në vendgrumbullimet e lagjeve. Shikoni ju lutemi informatat për secilën komunë veç e veç mbi vendgrumbullimin dhe llojet e ndryshme të mbeturinave. Gazetat dhe kartonat e vjetër të lidhura në dengje, në ditë të caktuara mund t'i nxirrni në skaj të rrugës suaj. Shërbimi ynë do t'i bartë që andej.

Festat

Viti i Ri (1 janar), 2 janar (Dita e Bertoldit), e Premtja e Madhe (Karfreitag), e Hëna e Pashkëve, (Ostermontag), Zoja Ndihmëtare (Auffahrt), E Hëna e Rrëshajës (Pfingstmontag), Korp i Krishtit (Fronleichnam), 1 Gushti (Festë Kombëtare), 15 gushti - Zoja e Madhe (Maria Himmelfahrt), 1 nëntori (Të gjithë Shenjtërit), 8 dhjetori- Zoja e Papërlyer (Maria Empfängnis), 25 dhjetor (Kërshëndellat) dhe 26 dhjetori (Dita e Stefanit). Në këto festa nuk punohet, edhe nëse ato qëllojnë në ditë pune dhe shitoret, me përjashtime të vogla, janë të mbyllura.

Kontaktet me organet zyrtare

Të përgjithshme

Enti për Çështje të të Huajve në Zug (Das Amt für Ausländerfragen Zug) vepron sipas Ligjit Federativ mbi të Drejtat e të Huajve në Kantonin e Zug-ut. Në këtë lëmi aty kryhen shërbime të gjithanshme për qytetarët vendas dhe të huaj. Si organ kantonial i punëve të jashtme, ky ent (Das Amt für Ausländerfragen) është gjithmonë kompetent kur të huajt duan të jetojnë ose të punojnë këtu (hyrje/ qëndrim) ose kur si strehimkërkues i dërgohen Kantonit të Zug- ut.

Enti për Çështje të të Huajve në Zug (Amt für Ausländerfragen Zug)

Verwaltungsgebäude 2 / Aabachstrasse 1

Postfach 857

6301 Zug

Telefon: 041 728 50 50

Fax: 041 728 50 59

E-mail: info.kafa@sd.zg.ch

Adresa e internetit: www.zug.ch/kafa

Orari i punës në sportel: 8.30 – 11.45 dhe 14.00 – 17.00 (Të hënën deri në orën 18.00), para festave deri më 16.00 h

Vendosja për banim në kantonin e Zug- ut/ Paraqitja

Të huajt duhet të paraqiten në Entin për Çështje të të Huajve tetë ditë pasi të kenë hyrë në kantonin e Zug- ut. Kjo vlen edhe për ata që vijnë nga ndonjë kanton tjetër

të Zvicrës. Për regjistrim nevojiten këto dokumente:

- Pasaportë ose letra e njohtimit për shtetas të UE- së ose EFTA -s
- Garancë për lejen e qëndrimit nëse punëdhënësi është nga një kanton tjetër
- 2 fotografi për pasaportë
- Lejen e njoftimit për shtetasit e huaj (Ausländerausweis) me vërtetimin që jeni çlajmëruar në vendbanimin e mëparshëm.
- Polisën e sigurimit shëndetësor dhe kundër aksidenteve

Pas paraqitjes suaj në Entin për Çështje të të Huajve (Das Amt für Ausländerfragen Zug), regjistrimi juaj në Zyrën për Evidentimin e Banorëve (Einwohnerkontrolle) bëhet automatikisht, kështu që ju nuk keni nevojë të paraqiteni në këtë Zyrë personalisht. Personave që duan të vendosen në kantonin e Zug- ut dhe që nuk janë shtetas të Unionit Evropian / EFTA-s ju rekomandohet që së pari ta bëjnë kërkesën për leje tek Enti për Çështje të të Huajve dhe vetëm pas marrjes së lejes të vendosen në kantonin e Zug- ut.

Ndërrimi i vendbanimit brenda kantonit të Zug- ut / shpërngulja jashtë shtetit

Personat që e ndërrojnë vendbanimin brenda kantonit të Zug- ut, duhet të çlajmërohen te Zyra për Evidentimin e Banorëve (Einwohnerkontrolle) në komunën ku kanë jetuar deri atëherë. Për këtë duhet të sillen leja e njoftimit për shtetas të huaj (Ausländerausweis).

Ndërrimi i kantonit

Nëse shpërnguleni në një kanton tjetër, duhet të çlajmëroheni te Zyra për Evidentimin e Banorëve (Einwohnerkontrolle) në komunën ku keni jetuar deri atëherë. Në këtë rast personave që nuk janë shtetas të UE (Unioni Evropian) dhe EFTA (Organizata Evropjane për Tregun e Lirë) u rekomandohet që së pari ta bëjnë kërkesën për leje në kantonin ku duan të shkojnë dhe vetëm pas marrjes së lejes të shpërngulen.

Qëndrimi i shtetasve të huaj me qëllim vizite

Sipas ligjit në fuqi, personat e huaj si turistë kanë të drejtë të qëndrojnë në Zvicër më së shumti dy herë nga tre muaj brenda një viti. Por pas një qëndrimi të pandërprerë tremujor janë të detyruar ta lëshojnë Zvicrën. Një vizitë e sërishme guxon të bëhet vetëm pasi të kalojë një muaj pas përfundimit të vizitës së mëparshme.

Një i huaj, të cilit i është lejuar qëndrimi turistik në Kantonin e Zug- ut, nuk ka nevojë që brenda asaj kohe të paraqitet.

Nëse një person (zvicëran ose i huaj me vizë B ose C), dëshiron që ta ftojë një mik, i këshillohet që së pari të informohet nëse i ftuari ka sigurim të mjaftueshëm shëndetësor dhe ndaj aksidenteve.

Për qëndrime të shkurtra (pushime, kurse, kongrese, vizita private) nuk ka nevojë të bëhet paraqitja. Nëse një qëndrim i këtillë është i planifikuar për më shumë se tre muaj, është e domosdoshme të kërkohet një leje gjegjëse. Pas marrjes së lejes dhe hyrjes në Zvicër i huaji duhet të paraqitet në Entin për Çështje të të Huajve (Das Amt für Ausländerfragen Zug) në Zug.

Kurorëzimet

Lidhja e kurorës bëhet vetëm para nëpunësit të Gjendjes Civile (Zivilstandsbeamte) në komunë. Informata më të sakta mbi formalitetet mbi shpalljen dhe lidhjen e kurorës ju jep Zyra e Gjendjes Civile (Zivilstandamt).

Lindjet

Lindjet në spitale i paraqiten drejtpërsëdrejti Zyrës së Gjendjes Civile. Lindjet në shtëpi duhet të lajmërohen nga familjarët ose mamia poashtu në Zyrën e Gjendjes Civile të vendbanimit ku ndodh lindja, më së voni brenda tri ditëve.

Raste vdekjesh

Çdo rast vdekjeje duhet të paraqitet nga të afërmit e të vdekurit në Zyrën e Gjendjes Civile brenda dy ditësh.

Papunësia

Të papunët janë të detyruar të kërkojnë vend të ri pune prej datës së shkëputjes së marrëdhënies së punës. Kështu ato mund t'i dëshmojnë përpjekjet e tyre për kërkimin e një vendi të ri pune, para paraqitjes si të papunë. Që të fitoni të drejtën për marrjen e të hollava nga Sigurimi për të papunë (Arbeitslosenversicherung), duhet që të paraqiteni në Entin Komunal për Punësim (Gemeindearbeitsamt), më së voni një ditë pas skadimit të afatit të shkresës për dorëheqje, apo pushimit nga puna. Për këtë janë të nevojshme këto dokumente: kartela AHV, kontrata e punës (nëse keni), shkresa e dorëheqjes apo pushimit nga puna dhe leja e qëndrimit për shtetas të huaj (Ausländerausweis).

Adresa të rëndësishme:

- Arbeitsamt der Wohnsitzgemeinde
- Arbeitslosenkasse des Kantons Zug, Industriestrasse 24, 6300 Zug, Tel. 041 728 29 00
- Regionales Arbeitsvermittlungszentrum (RAV) Zug,
Hertizentrum 6, 6300 Zug,
Telefon 041 728 25 88
- Verein für Arbeitsmarktmassnahmen (VAM), Hofstrasse 15, 6300 Zug,
Telefon 041 728 34 88
- ZALT (Zuger ArbeitsLosenTreff), Bundesplatz 7, 6300 Zug, Telefon 041 711 78 14

Personat me leje të përhershme qëndrimi (me vizën C) janë të detyruar të bëjnë deklarin e të ardhurave të tyre për tatim

Personave të huaj që nuk kanë leje qëndrimi C, tatimi u zbritet drejtpërsëdrejti prej rrogës (Quellensteuer). Këtu bëhet fjalë për personat me leje vjetore qëndrimi (vizë B), me leje qëndrimi brenda javës, me qëndrim afatshkurtër, azilkërkues dhe banorë të zonave kufitare. Personat me leje të përhershme qëndrimi (me vizën C), janë të detyruar ta bëjnë deklarin e të ardhurave të tyre për tatim çdo vit. Administrata Tatimore e Kantonit (Die Kantonale Steuerverwaltung) ju informon me kënaqësi nëse i drejtoheni me pyetje. Emri i ekspertit/referentit përgjegjës është gjithmonë i shkruar në formularin për tatim.

Kantonale Steuerverwaltung Zug

Abteilung Natürliche Personen

CH-6301 Zug

Tel: +41(0)41 728 26 11

Fax: +41(0)41 728 26 98

Adresa e internetit: www.zug.ch/tax

Marrja e nënshtetësisë

Marrja e nënshtetësisë në kushte normale

Kërkesa për marrjen e nënshtetësisë bëhet në komunë. Atë mund ta bëjnë personat që kanë jetuar më së paku 12 vjet në Zvicër dhe atë 5 vjet në Kantonin e Zug-ut, ndërsa 3 vjet pandërprerë në komunën ku duan ta marrin nënshtetësinë.

Të rinjtë, në parim mundën të bëjnë kërkesë edhe vetë, nëse i plotësojnë kushtet e kërkuara me ligj. Koha e kaluar në Zvicër mes moshës 10 – 20 vjeçare llogaritet dyfish. Çfarë kushtesh tjera duhet të plotësoni?

- Të jeni mirë të informuar mbi jetesën dhe zakonet zvicerane, kantonale dhe lokale.
- Të keni njohuri të mjaftueshme të gjuhës, që të mund të merreni vesh me organet zyrtare dhe me popullatën.
- Të keni burime të sigurta financiare (të mos keni marrë ndihma sociale gjatë tri viteve të fundit. Ato ndihma nuk llogariten si burime të sigurta financiare).
- Të mos jeni i dënuar në Zvicër, të mos jeni nën pagesë të detyrueshme (Betreibung) dhe tatimin ta keni paguar me kohë.

Marrja e nënshtetësisë në rrethana lehtësuese

Për të rinjtë, të cilët e bëjnë kërkesën mes moshës 11 – 22 vjeçare si dhe për bashkëshortin ose bashkëshorten e një zvicerani ose zviceraneje ekziston mundësia për marrjen e nënshtetësisë në rrethana lehtësuese.

Më saktë mbi kushtet dhe çështjet tjera mbi të Drejtën Qytetare ju këshillojnë në Drejtorinë e Punëve të Brendshme (Direktion des Innern) në repartin e Gjendjes Civile dhe të Drejtës Qytetare, në ndërtesën e Administratës - Verwaltungsgebäude am Postplatz, 6301 Zug, Telefoni 041 728 31 73

Kërkesa për marrjen e nënshtetësisë duhet të dërgohet në:

Direktion des Innern des Kantons Zug (Drejtoria Kantonale e Punëve të Brendshme Zug)
 Postfach 146
 6301 Zug
 Tel.: 041/ 728 24 30
 Fax: 041/ 728 37 17

Punësimi

Hyrja në Zvicër

Qëndrimi i shtetasve të huaj në Zvicër me qëllim punësimi, është i kushtëzuar me marrjen e një leje punësimi. Leje për punësim shtetasve të huaj që për herë të parë hyjnë në Zvicër, u jipet së pari atyre nga Unioni Evropian (UE) dhe nga Organizata Evropiane e Tregut të Lirë (EFTA). Të gjithë të tjerët bëjnë pjesë në rrethin e dytë dhe lejen për qëndrim dhe punësim e marrin në kushte më të vështira.

Në rastet kur personat me leje vjetore qëndrimi ose me leje për qëndrim afatshkurtër vijnë për herë të parë për të punuar dhe banuar në Zvicër, Enti kantonal për Ekonomi dhe Punë (KWA) e bën verifikimin nëse plotësohen kushtet e parapara. Sipas vendimit të këtij enti (për shtetas të UE/EFTA), Enti për Çështje të të Huajve (KAFA) e jep lejen për qëndrim dhe punësim. Në të gjitha rastet tjera Enti për Çështje të të Huajve (Das Amt für

Ausländerfragen Zug) e jep lejen e qëndrimit dhe punësimit, vetëm pas një vendimi pozitiv të Entit Federativ për Migrim, Integrim dhe Emigrim (IMES).

Ndërrimi i vendit të punës

Shtetasit e huaj që kanë leje vjetore ose leje afatshkurtër qëndrimi për punë (shtetas të UE/EFTA dhe pjestarët e familjeve të tyre) janë të lirë ta ndërrojnë vendin e punës. Kjo do të thotë që këta persona nuk kanë nevojë të nxjerrin leje pune kur e ndërrojnë vendin e punës. Edhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm (vizë C) nuk u duhet leje për punësim ose për ndërrimin e vendit të punës.

Të huajve me **vizë B** (leje vjetore) u duhet leje pune për çdo ndërrim të vendit të punës.

Punëdhënësi duhet të bëjë kërkesë për leje pune tek Enti për Ekonomi dhe Punë në Zug (Amt für Wirtschaft und Arbeit). Formularët e nevojshëm për aplikim dhe fletë tjera me udhëzime përkatëse mund të merrni në internet në rubrikën www.zug.ch/kwa Formulare/Download.

Informata mund të merrni edhe në:

Amt für Wirtschaft und Arbeit (KWA)

Abteilung Arbeitskräfte
Aabachstrasse 5
CH-6301 Zug
Tel: ++41(0)41 728 55 20
Fax: ++41(0)41 728 55 29
E-Mail: info.kwa@vd.zg.ch
www.zug.ch/kwa

Bundesamt für Zuwanderung, Integration und Auswanderung (IMES)

Quellenweg 15
3003 Bern
Tel: ++41(31) 325 95 11
Fax: ++41(31) 325 95 51
E-Mail: info@imes.admin.ch
www.imes.admin.ch

Marrëveshjet bilaterale Zvicër – UE/EFTA

Më 1 qershor 2002 hyri në fuqi marrëveshja mes Zvicrës dhe UE/EFTA për lëvizjen e lirë të personave.

Sipas kësaj marrëveshjeje, shtetasit e UE/EFTA dhe familjarët e tyre kanë të drejtë të hyjnë në Zvicër, të qëndrojnë dhe të punojnë këtu nëqoftëse i plotësojnë kushtet që janë parashtruar në marrëveshje. Shtetasit e UE/EFTA gëzojnë lëvizje të lirë dhe munden ta ndërrojnë vendin e tyre të punës kur të duan.

Formularët e nevojshëm për aplikim dhe fletë tjera me udhëzime përkatëse mund të merrni në internet në rubrikën www.zug.ch/kwa Formulare/Download.

Oferta për arsimimin e të rinjve dhe të rriturve

Kurse të gjuhës gjermane

Njohja e gjuhës gjermane do t'ju lehtësojë shumë gjëra: kontaktin me popullatën vendase, komunikimin me organet zyrtare, informimin nëpërmjet radios, televizionit dhe gazetave. Njohuritë e gjermanishtes janë një përparësi e madhe, sidomos kur kërkoni punë ose kur

doni ta ndërroni vendin e punës. Shkolla të ndryshme private dhe shtetërore ofrojnë kurse për gjermanisht.

Listën me të gjitha kurset e gjuhës gjermane në kantonin e Zug- ut mund ta merrni në këtë adresë:

Caritas Schweiz

Geschäftsstelle für Integrationsfragen und gegen Rassismus des Kanton Zug
(Zyra për Çështjet e Integritit dhe kundër Racizmit e Kantonit të Zug- ut)
Neugasse 11, Postfach 1218, 6301 Zug, Telefon 041/726 07 70

Shkolla për integrim

Shkolla për integrim është një mundësi ndërlidhëse për të huajt që kanë ardhur vonë në Zvicër, të rinj mes moshës 16-20 vjeçare që e kanë kryer shkollimin e obligueshëm, si dhe për nxënës që janë 1-2 vjet para mbarimit të shkollimit të obligueshëm dhe që nuk flasin fare ose flasin vetëm pak gjermanisht. Në këtë shkollë këta të rinj përgatiten sipas moshës dhe aftësive të tyre për një zeje ose për vazhdimin e shkollimit të mëtutjeshëm. Në programin e kësaj shkolle përfshihet të mësuarit e gjuhës gjermane për të huaj dhe lëndë të tjera mësimore. Qëllimi kryesor i kësaj shkolle është integrimi shoqëror i këtyre të rinjve.

Informata:

Zuger Integrationsschule
Grienbachstrasse 11, 6300 Zug
Telefon 041 766 03 70 Fax 041 766 03 79

Këshillimorja për zgjedhjen e profesionit dhe për ngritjen profesionale

Qendra Informative e Zug- ut për Zgjedhjen e Profesionit (Berufsinformationszentrum-BIZ), Baarerstrasse 21, 6300 Zug i këshillon të rinjtë, të rriturit dhe të papunët për zgjedhjen e profesionit dhe për riorientim, si dhe për çështjet e financimit të shkollimit. Informata mbi llojet e zejeve dhe shkollave, mund të merrni në tel. 041 728 32 18 të martën, prej orës 13.30 deri në orën 18.00, të mërkurën dhe të enjten, prej orës 13.30 deri në orën 19.30 . Listën e vendeve të punës për nxënës mund ta merrni në Qendrën Informativë të Zug- ut (BIZ) gjatë orarit të punës, me telefon: çdo ditë pune nga ora 8.00 deri më 12.00, përveç ditën e mërkurë, prej orës 13.30 deri më 19.30 - gjithashtu përmes tel. 041 728 32 18.

Sistemi shkollor në Zug

Viti shkollor fillon në gjysmën e dytë të muajit gusht.

Kopshti i fëmijëve: nuk është i obligueshem, por ju rekomandohet

Kopshti i ofron fëmijës suaj mundësi që ta mësojë gjuhën gjermane dhe të përgatitet për ta ndjekur mësimin në shkollë të rregullt. Qëndrimi në kopsht është falas. Për të gjithë ata fëmijë, që deri në fund të shkurtit i kanë mbushur 4 vjet, në vitin vijues rekomandohet shkuarja në kopsht. Fëmijët regjistrohen automatikisht.

Shkolla fillore është e obligueshme dhe falas

Për të gjithë fëmijët që deri në fund të shkurtit i kanë mbushur 6 vjet, vijimi i shkollës fillore është i detyrueshëm. Regjistrimi i fëmijëve në këtë shkollë bëhet automatikisht. Shkolla fillore zgjat nëntë vjet.

Informata:

Rektoratet e shkollave ju informojnë me kënaqësi.

Bursa

Kush ka të drejtë të kërkojë bursë në Kantonin e Zug-ut?

Personat, që pas shkollimit të obligueshëm bëjnë një shkollë apo një zeje që njihet nga Federata ose Kantonin e Zug-ut si shkollim me të drejtë burse dhe që e kanë të drejtën e bursës në kanton, mund të bëjnë kërkesë për bursë (të huajt duhet të kenë vizë B ose C dhe të kenë jetuar në Zvicër 5 vjet). Për ndarjen e bursave merren parasysh kushtet financiare personale dhe ato të prindërve. Për këtë kandidatët duhet të bëjnë kërkesë. Formularët e nevojshëm mund t'i merrni në Këshillimoren për bursa (Stipendien-Beratungsstelle), Baarerstrasse 19, 6304 Zug ose mund t'i kërkonit në numrin e telefonit 041 728 37 41.

Adresa në internetit: www.zug.ch/stipendien.

Familja dhe edukimi

Këshillimorja për nëna dhe baballarë (Mutter- und Väterberatung)

Në komuna të ndryshme ekzistojnë këshillimore për nëna dhe baballarë me foshnje dhe fëmijë të vegjël.

Adresat që ju duhen për të kontaktuar mund t'i merrni në komunën ku jetoni.

Përkujdesje për fëmijët tuaj derisa jeni në punë

Fëmijët e moshës parashkollore mund t'i dërgoni në çerdhe ose te një dado (Tagesmutter). Prindërit duhet të marrin përsipër një pjesë të shpenzimeve.

Adresat që ju duhen për të kontaktuar mund t'i merrni në komunën ku jetoni.

Zyrat për informim dhe këshillim

Mbi çështjet dhe problemet nga të gjitha lëmitë e jetës, në kantonin e Zug-ut ekziston një rrjet i gjërë këshillimorësh. Atje mund t'ju këshillojnë dhe ndihmojnë persona profesionistë dhe kompetentë.

Caritas Schweiz (*Geschäftsstelle für Integrationsfragen und gegen Rassismus Zug*)**Zyra për çështjet e integritit dhe kundër racizmit në kantonin e Zug- ut**

Neugasse 11, Postfach 1218, Zug 6301

Tel. 041 726 07 70, Fax. 041 726 07 71

Email: info@zg.caritas.ch

Nga e hëna deri të premten, prej orës 10:00 –12:00 dhe 13:30 –16:00

-Përpunimi i projekteve në lëmin e integritit

-Informata mbi integritimin dhe racizmin

Fachstelle Migration (Fsm) - Zyra e Migracionit

Zeughausgasse 9, Postfach 1258, 6301 Zug

Telefoni 041 728 23 12, Fax 041 728 23 14

E-Mail: fachstelle.migration@fsm-zug.chAdresa në internet: www.fsm-zug.ch

Bën këshillime në këto gjuhë: Boshnjakisht, gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht, kroatisht, portugalisht, serbisht, spanjisht dhe turqisht.

Qendra e gruas në Zug (Frauenzentrale Zug)

Tirolerweg 8, 6300 Zug, 041 725 26 00

Shërbimi telefonik: Prej të hënës deri të premten, prej orës 8.30 – 12.30

Adresa e internetit: www.zug.ch/frauenzentrale**triangel**Shërbime këshillimi të komunës kishtarë evangjeliste-reformative në kantonin e Zug- ut
(*Beratungsstelle der evangelisch-reformierten Kirchgemeinde des Kantons Zug*)

Gotthardstrasse 14, 6304 Zug

Telefoni 041 728 80 80, Faks 041 728 80 70 Email: triangel@tic.chAdresa e internetit: www.ref-kirche-zug.ch**Sozialinfo Zug**

- Informon mbi këshillimet sociale dhe organizatat shoqërore në kantonin e Zug- ut
- Mundëson kontakte me ekspertë dhe zyra
- Informon mbi përkudeshjen plotësuese të fëmijëve

Tel. : 041 728 38 38 / Walter Maurer, fax: 041 728 37 17, Email: sozialinfo.zug@di.zg.ch

Informata përmes tel. mund të merrni nga e hëna deri të premten prej orës 8.30 - 11.00

Shihni edhe përmes internetit: www.zug.ch Index / Beratung-Infos / Beratungsstellen**ZALT** (Zuger ArbeitsLösen Treff)

Bundesplatz 7, 6300 Zug, Telefon 041 711 78 14

Email: zalt@freesurf.ch**Zuger Fachstelle – punkto Jugend und Kind (Zyra e Zug- ut për të rinj dhe fëmijë)**

Bundesplatz 12, 6300 Zug

Telefon 041 728 34 40 – Fax 041 728 34 49

Email: mail@punkto-zug.chInternet: www.punkto-zug.ch**Sëmundjet, aksidentet, sigurimi shëndetësor**

Mos e lini pa bërë sigurimin shëndetësor dhe atë ndaj aksidenteve

Në Zvicër sigurimi shëndetësor është i detyrueshëm. Pra, ata që jetojnë në Kantonin e Zug-ut ose që qëndrojnë këtu më gjatë se tre muaj, janë të detyruar të bëjnë sigurimin për ndihmë mjekësore (shpenzimet e mjekut dhe spitalit). Ju lutemi kontaktoni menjëherë me ndonjë arkë të sigurimit shëndetësor (Krankenkasse). Nëse nuk veproni kështu, do të duhet që në rast nevojë shpenzimet e mjekut dhe spitalit t'i paguani vetë dhe të llogarisni në një taksë shtesë të pagesës mujore të sigurimit. Nëse edhe më tutje në vendin tuaj jeni i obliguar të paguani sigurimin shëndetësor, bëni kërkesë që të lirohëni nga ky obligim. Sigurimi i obligueshëm shëndetësor pranë një arke sigurimi, i mbulon shpenzimet e trajtimit spitalor apo të mjekut, si gjatë sëmundjes, ashtu edhe në periudhën pas aksidentit. Ia vlen të pyesni nëse te punëdhënësi juaj jeni i siguruar kundër aksidenteve në punë dhe atyre jashtë orarit të punës. Në rast të sigurimit të dyfishtë, pranë arkës së sigurimeve mund ta anuloni sigurimin ndaj aksidenteve dhe kështu ta zvogëloni pagesën tuaj mujore. Për këtë informohuni me kohë te punëdhënësi juaj ose te ndonjë këshillimore.

Mjeku / mjekja që e flet gjuhën tuaj?

Për informata drejtoheni në:

Zyra e Migracionit (Fachstelle Migration), Zeughausgasse 9, Postfach 1258, 6301 Zug

Tel. 041 728 23 12, Fax 041 728 23 14

E-Mail: fachstelle.migration@fsm-zug.ch

Adresa në internet: www.fsm-zug.ch

Urgjencat mjekësore

Nëse sëmureni papritur, nëse keni dhimbje të mëdha, në rast aksidenti apo problemesh urgjente me dhëmbët, paraqituni te mjeku te i cili jeni në mjekim, te mjeku i familjes ose te zëvendësuesit e tyre edhe jashtë orarit të punës. Vetëm atëherë kur nuk mund t'i gjeni këta, mund ta thirrni ndihmën e shpejtë.

Telefonat e Urgjencës

Sanineti (ndihma e shpejtë) tel. 144

Policia 117

Zjarrfikësit 118

Shërbimi urgjencës mjekësore dhe dentare 041 211 14 14

Qendra toksikologjike (Tox-Zentrum), në raste helmimi 145

Dora e Shtrirë (Dargebotene Hand) biseda në gjendje krize 143

Shtëpia e gruas Zürich (Frauenhaus Zürich) 01 363 22 67

Shtëpia e gruas Luzern (Frauenhaus Luzern) 041 360 70 00

Help O Fon -Telefon kujdestar për fëmijë dhe të rinj 157 00 57

Urgjenca për prindër Zug-Zürich 01 710 22 55

Ndihma kur u prishet automjeti në rrugë (Automobile Pannenhilfe TCS/ACS) 140

Urgjenca të tjera përmes telefonit 111

Rega 1414

A jeni i siguruar sa duhet?

Informohuni mirë se cilat sigurime janë për ju të nevojshme dhe që ia vlen t'i bëni (sigurimi për dëmshpërblim, sigurimi i orendive shtëpiake dhe shumë sigurime të tjera). Secila shoqatë sigurimi ju këshillon falas.

Koha e lirë dhe sporti

Biçikleta falas!

Komunat e Kantonit të Zug- ut kanë shumë rrugë interesante për biçikleta (Tabelat udhërrëfyese janë me ngjyrë të kuqe në të kafesë). Në komunën e Baar- it (para Bashkisë) dhe në atë të Zug- ut në (Bundesplatz) që nga maji e deri në tetor, prej orës 9 e deri më 21 mund të huazoni falas nje biçikletë ose një trotinet. Edhe në Cham, pranë Mandelhof- it mund të huazoni biçikleta falas. Për këtë ju mjafton vetëm dorëzimi i letrës suaj të njoftimit.

Ku mund ta kaloni kohën e lirë

Informata të sakta mbi shfaqjet zbavitëse dhe kulturore mbrenda javës mund të gjeni çdo të premte në shtypin e përditshëm dhe në *Amtsblatt*.

Rekreacioni

Zyra turistike “Zug Tourismus” e boton një fletushkë me informata mbi shëtitjet, pikniqet, sportin dhe muzetë në Kantonin e Zug- ut.

Vendi ku mund ta gjeni:

Zug Tourismus, Reise Zentrum Zug, Bahnhofplatz, 6304 Zug, Tel.041 723 68 00

Adresa e internetit: www.zug-tourismus.ch

Sporti

Kantoni i Zug- ut me pejzazhet e tij të larmishme ju ofron mundësi të shumta për t`u marrë me sport. Në faqen e internetit të Zug Tourismus www.zug-tourismus.ch do të gjeni shumë rekomandime.

Administrata e komunës suaj ju informon me kënaqësi mbi shoqatat dhe klubet gjimnastikore dhe sportive që veprojnë në rrethin tuaj.

Bibliotekat

Në të gjitha komunat e Zug- ut ekzistojnë biblioteka. Për informata drejtohuni në administratën lokale. Në ato biblioteka do të gjeni edhe literaturë në gjuhë të huaja. Në Zug gjindet edhe Biblioteka e Qytetit dhe Kantonit, në Oswaldgasse 21, telefoni 041 728 23 13.

Adresa me rëndësi

Organizatat e të ardhurve/ migrantëve

Adresat e shoqatave të ndryshme kulturore dhe kombëtare mund t'i merrni në:

Fachstelle Migration

Telefoni 041 728 23 10

E-Mail: fachstelle.migration@fsm-zug.ch

Adresa në internet: www.fsm-zug.ch

dhe në

Integrationsnetz Zug

www.integrationsnetz.org

Vendtakimet e të rinjve në kanton

Jugendkulturzentrum (Qendra kulturore e rinisë) në Zug, Industriestrasse 45, www.i45.ch

Jugendtreff Hünenberg, www.cluba2.ch

Jugendtreff – Menzingen, Holhäusernstrasse 12,

www.zugernet.ch/jugendarbeit/jugendtreff/jugi

Galvanik Zug, Hammerstrasse 173, www.galvanik-zug.ch/

Jugendteam Baar, www.itbaar.ch.vu/

Zug- u në internet: www.zug.ch

Lexoni faqen e internetit të kantonit të Zug- ut. Aty do t'i gjeni informatat më të reja dhe në detaje mbi Kantonin e Zug- ut. Me linket përkatëse keni qasje direkte në të gjitha komunat.

Ju kujtojmë

Se këtë broshurë e përpiloi Zyra e Migracionit (Fachstelle Migration), më parë Këshillimorja për të Huaj (Ausländerberatungsstelle), në bashkëpunim me Kantonin dhe me komunat veç e veç. Është e përkthyer në më shumë gjuhë dhe do të përpunohet dhe plotësohet vazhdimisht.

Zug, maj 2004

Përmbajtja

Faqja

Adresat

15

Bibliotekat

14

Biçikleta falas	14
Bursat	11
Familja dhe edukimi	11
Festat	5
Këshilla për nëna dhe baballarë	11
Këshillime mbi zgjedhjen e profesionit dhe shkollim të mëtejme	10
Këshillimoret	12
Koha e lirë dhe sporti	14
Komunat	2
Komunikacioni	3
Kopshtet e fëmijëve	10
Kurorëzimi	7
Kurse për integrimin e të rinjve	10
Kurset e gjuhës gjermane	9
Lejet e punës	8
Lindjet	7
Marrëveshja bilaterale mes Zvicrës dhe Unionit evropian	9
Marrja e nënshtetësisë	8
Mbeturinat	5
Oferta për arsimimin e fëmijëve dhe të rriturve	9
Papunësia	7
Parlamenti Kantonal	3
Përpunimi i projekteve në lëmin e integritimit	12
Qeveria	3
Rastet e vdekjes	7
Shoqatat e të ardhurve-migrantëve	15
Sigurimet ndaj sëmundjeve dhe fatkeqësive	13
Sistemi shkollor	10
Tatimi	7
Telefonat e urgjencës	13
Tregu	4
Vendtakimet e të rinjve	15
Zug- u në internet	15
Zyrat për informim dhe këshillim	11